



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME
DREJTORIA E ARKIVIT HISTORIK DHE DOKUMENTACIONIT

SKEMA E INDEKSIMIT DHE E EKSPERTIZËS TË DOKUMENTEVE MEPJ

Tiranë, shkurt 2026

Miratoi

ELISA SPIROPALI, MINISTËR PËR EVROPEN DHE PUNET E JASHTME

PARATHËNIE

Në përputhje me:

- a- dinamikën e zhvillimeve të diplomacisë shqiptare, pasqyruar në rritjen cilësore dhe sasiore të dokumentacionit që krijohet nga shërbimi i jashtëm shqiptar,
- b- evolucionin e kërkesave dhe interesave studimore të publikut
- c- nevojave të politikës së jashtme shqiptare për t'ju referuar historisë së zhvillimeve diplomatike shqiptare,

Drejtorja e Arkivit Historik dhe Dokumentacionit rishikon në mënyrë periodike Skemën e Indeksimit dhe të Ekspertizës së dokumenteve të krijuara nga i gjithë sistemi i shërbimit të jashtëm shqiptar.

Skema e Indeksimit dhe Ekspertizës të Dokumenteve në MEPJ, shërben për të arritur në një trajtim unik profesional dhe serioz të dokumentacionit në të gjitha segmentet e strukturës së shërbimit të jashtëm shqiptar. Kjo e bën më të lehtë aksesin ndaj dokumentacionit historic të trashiguar dhe atij të krijuar rishtas dhe vënien e tij në shfrytëzim të interesave shtetërorë dhe publike.

Skema e Indeksimit dhe Ekspertizës të Dokumenteve në MEPJ, është dokumenti bazë i punës me dokumentacionin. Ajo ndihmon specialistin-krijues të praktikave dokumentare në përcaktimin e indeksit të klasifikimit për problematikën që trajton, ashtu edhe për specialistët e përpunimit të dokumentacionit në Arkivin Historik të MEPJ-së në procesin e shndërrimit të kësaj praktike dokumentare në praktikë studimore.

Skema e Indeksimit dhe Ekspertizës të Dokumenteve në MEPJ, është organizuar në *Indekse* sipas problematikave dhe drejtimeve të aktivitetit të shërbimit të jashtëm shqiptar, ndërsa *Nënindekset* janë detajim i problematikës në specifika më të ngushta. Secili nga nënindekset shoqërohet me afatet përkatëse kohore të vlerës së ruajtjes së dokumentit apo praktikës, sipas specifikave përkatëse, por njëkohësisht duke u referuar në Listën Tip të afateve të ruajtjes së dokumenteve administrative të shtetit shqiptar. Në këtë mënyrë kjo Skemë bën edhe ndarjen e madhe të pasurisë dokumentare të shërbimit të jashtëm shqiptar në fond dokumentar me cilësimin “Rëndësi Historike Kombëtare” dhe në fond dokumentar me vlerë ruajtje të përkohshme.

Drejtorja e Arkivit Historik dhe Dokumentacionit

INDEKSET

- A.** Objektivat e politikës së jashtme dhe shërbimit të jashtëm shqiptar. Rregullore, urdhëra e udhëzime për realizimin e tyre. Analiza të punës në MEPJ e përfaqësi, studime me karakter tematik dhe përgjithësues, bashkëpunimi me institucionet e tjera për probleme të përgjithshme të politikës së jashtme.
- B.** Marrëdhëniet dypalëshe të shtetit shqiptar:
 - B/I** Marrëdhëniet politike e ushtarake
 - B/II** Marrëdhëniet social-ekonomike
 - B/III** Marrëdhëniet kulturore, arsimore, shkencore e shëndetësore
 - B/IV** Gjendja e brëndshme në vende të ndryshme
 - B.V** Kosova dhe Faktori Shqiptar në Rajon
- C** Organizmat ndërkombëtare.
- C/BE Bashkimi** Evropian
 - Ç** Organizata dhe veprimtari me karakter rajonal.
 - D** Aktiviteti i diasporës dhe shqiptarëve jashtë vendit
 - DH** Diplomacia publike dhe teknologjia e informacionit
 - E** Çështje me karakter protokollar
 - Ë** Probleme konsullore
 - F** Praktikat për nënshkrimin dhe ratifikimin e traktateve e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, dhe probleme të tjera juridike të lidhura me to. Marrëdhëniet me Gjykatat Ndërkombëtare për çështje të ndryshme.
 - H** Evidentimi dhe arkivimi i dokumentacionit diplomatik. Biblioteka e MPJ-së.
 - I.** Probleme të menaxhimit të burimeve njerëzore.
 - J.** Çështje financiare dhe administrative

Këto indekse do të plotësojnë rubrikën “Indeksi_____” të formatit të shkresës që krijohet në MEPJ.

A • **Objektivat e politikës së jashtme dhe shërbimit të jashtëm shqiptar.**

Rregullore, urdhëra e udhëzime për realizimin e tyre. Analiza të punës në MEPJ e përfaqësi, studime me karakter tematik dhe përgjithësues, bashkëpunimi me institucionet e tjera për probleme të përgjithshme të politikës së jashtme

1. Platforma, programe pune afatgjata, ligje, dhe rregullore për shërbimin e jashtëm të miratuara me akte nënligjore. (RHK)

2. Rregulloret e brendshme të MEPJ për të gjitha problemet që kanë të bëjnë me shërbimin e jashtëm. Udhëzime të MEPJ me karakter orientues dhe afatgjatë për përfaqësitë dhe aparatet e MEPJ-së. Qarkore të brendshme të përfaqësive. (RHK)

3. Objektiva dhe plane pune vjetore, si dhe analizat përkatëse të punës së MEPJ, të drejtorive të veçanta, ashtu edhe të përfaqësive diplomatike e konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit:

- a) Ato me afat 6 muaj, 1 vit ose më shumë (RHK)
- b) Ato me afat më të shkurtër se 6 muaj (5 vite)

4. Referate, raporte, procesverbale të diskutimeve në seminare apo takime kolegjiale me tematikë të ndryshme që organizon MEPJ, si dhe të seminarit të përvitshëm me titullarët e përfaqësive të RSH jashtë vendit. (RHK)

5. Studime, analiza dhe materiale përmbledhëse për problematika dhe situata të caktuara në politikën e jashtme shqiptare dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare (RHK).

6. Studime dhe analiza për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik e kulturor në vend, dhe përmasat e diplomacisë ekonomike e asaj kulturore shqiptare (RHK)

7. Buletini i aktivitetit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe përfaqësive (RHK)

8. Marrëdhëniet e MEPJ-së me institucionet e tjera për problematika të përgjithshme. (RHK)

9. Marrëdhëniet e MEPJ-së me Drejtoritë e Marrëdhënieve me Jashtë në institucionet e tjera. (RHK)

B

MARRËDHËNIET DYPALËSHE TË SHTETIT SHQIPTAR

B.I Marrëdhëniet dypalëshe politike e ushtarake

1- Marrëdhëniet diplomatike midis shteteve (RHK)

a-Njohje reciproke shtetesh e qeverish.

b-Bisedimet për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike, ngritja e rangut të përfaqësimit diplomatik.

c-Ndërprerja e marrëdhënieve diplomatike.

d-Ndryshime të nivelit të përfaqësimit, largim e rikthim diplomatësh të huaj. Dëbim diplomatësh të huaj të padëshiruar dhe anasjelltas.

e-Hapja dhe mbyllja e përfaqësive diplomatike dhe konsullore. Vendimet përkatëse të qeverisë shqiptare e praktika e miratimit të tyre.

ë-Akreditim i atasheve ushtarakë në vendet e tjera dhe anasjelltas.

2-Deklarata, intervista, letra, nota e telegrame të personaliteteve politike të shtetit shqiptar për qëndrimin e shtetit shqiptar ndaj shteteve me të cilat ka marrëdhënie diplomatike. (RHK)

Deklarata, intervista, letra, nota e telegrame politike të personaliteteve të huaja (shtetërore dhe shoqërore) për qëndrimet e opinionet e tyre ndaj shtetit shqiptar. (RHK)

3-Informacione për takimet e punës të personaliteteve të larta politike të shtetit shqiptar dhe forcave politike me personalitete të huaja në fushën e politikës ose në fusha të tjera dhe anasjelltas. (RHK).

4-Shkëmbime vizitash, delegacionesh shtetërore të çdo niveli me vendet e tjera. Pergatitja e vizitës, tezat e bisedimeve, informacionet përmbledhëse për rezultatet e vizitës. (RHK).

5-Qëndrimet dhe përkrahjet e shtetit shqiptar ndaj kandidaturave të shteteve me të cilat ka marrëdhënie diplomatike, dhe anasjelltas, në konferenca dhe organizata ndërkombëtare. (RHK)

6-Qëndrimet e shtetit shqiptar ndaj lëvizjeve të ndryshme shoqërore në vendet e tjera. (RHK).

7-Dekorimet e personaliteteve të huaja në kuadrin e marrëdhënieve politike midis shteteve. (RHK)

8-Telegramet dhe mesazhet e çdo lloji të shkëmbyer midis institucioneve, udhëheqësve dhe personaliteteve të larta të shtetit shqiptar me ato të vendeve të tjera, me rastin e festave kombëtare, Vitit të Ri, zgjedhjeve ose emërimeve në detyrë, fatkeqësive natyrore, etj. (RHK)

9-Rënie dakort në parim për arritjen e nënshkrimit të marrëveshjeve të veçanta në fushën e bashkëpunimit politik dhe ushtarak. Informacione, materiale lidhur me zbatimin e marrëveshjeve që shteti shqiptar ka me shtetet e tjera. (RHK)

10-Dokumente mbi kufirin, çështjet kufitare, pikat e kalimit incidentet, provokacionet, ndërhyrjet dhe protestat që lidhen me to etj. (RHK).

11-Opinionit publik i huaj për vendin tonë. Informacione të sjella nga përfaqësitë për komentet e medias të shkruar dhe elektronike në vendet ku ato janë të akredituara.

- a. Informacione përmbledhëse të të gjitha mediave vendase për ngjarje të caktuara politike apo sociale në vendin tonë, ose komentet për zhvillimet politike-shoqërore në Shqipëri të marra nga media e shtetit ku janë akredituar. (RHK)
- b. Njoftime të zakonshme nga media të ndryshme shtypi në vendin ku janë akredituar përfaqësitë e RSH, për ngjarje rutinë në Shqipëri. (5 vite).

12-Mbi strehimin politik në Shqipëri. (RHK)

13- Ndikimi i aktivitetit të shqiptarëve jashtë vendit në marrëdhëniet midis dy vendeve. (RHK)

B. II. Marrëdhëniet dypalëshe sociale dhe ekonomike

1-Informacione për nivelin e zhvillimit të marrëdhënieve ekonomike dypalëshe. (RHK)

2- Vizitat reciproke të niveleve të ndryshme në kuadrin e bashkëpunimit ekonomik. Tezat e bisedimeve, dosja e vizitës dhe rezultatet e saj. (RHK)

3- Korrespondencë e MPJ-së me ministrinë e tjera në vend për realizimin e një bashkëpunimi ekonomik dypalësh me shtetet e tjera. (RHK)

4- Propozimet dhe rënie dakort për nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe në fushën e bashkëpunimit ekonomik. Praktika e ndjekies së zbatimit të marrëveshjeve dypalëshe të nënshkruara në fushën e bashkëpunimit ekonomik. (RHK)

5-Takime e sesione pune të Komisioneve të Përbashkëta në kuadrin e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit ekonomik e tregëtar me vendet e tjera. (RHK).

6-Tregtia.

a. Akreditimi i Atasheve Tregtare në vendet e tjera dhe anasjelltas. (RHK)

b. Marrëdhëniet tregtare të sferave të ndryshme, shkëmbim delegacionesh etj. (RHK).

c. Panaire, ekspozita dhe aktivitete të tjera tregtare (10 vite)

d. Doganat. (50 vite)

7-Informacione për interesimin e biznesit të huaj për të investuar në Shqipëri ose për të bashkëpunuar me biznesin shqiptar. (10 vite).

8-Ndihmat, kreditë, borxhet financiare. (RHK).

9-Takime, biseda e rënie dakort për nënshkrim marreveshjeje me shtetet e tjera në fushën e punësimit sezonal dhe emigracionit ekonomik. (RHK)

10-Bashkëpunim me agjensi shtetërore ose jo në fushën e asistencës sociale për kategori të ndryshme të shoqërisë shqiptare. (RHK)

B.III

Marrëdhëniet dypalëshe kulturore, arsimore

dhe shëndetësore

- 1-** a. Materiale mbi marrëveshjet e bashkëpunimit kulturor, planet kulturore, shkëmbime delegacionesh. Vendimet e qeverisë shqiptare për këto probleme. Puna për ndjekjen e zbatimit të këtyre marrëveshjeve. Aktivitete kulturore në kuadër të këtij bashkëpunimi. (RHK)
b. Korrespondencë për probleme rutinë në këtë fushë veprimtarie (10 vite)
- 2-** Bashkëpunimi midis qyteteve. (RHK)
- 3-** Krijimi dhe veprimtaria e shoqatave kulturore të miqësisë në Shqipëri dhe në vendet e tjera, miqtë, ftesat, vizitat dhe veprimtaria e tyre. (RHK)
- 4-** a. Arsimi, shkenca, letërsia, arti, sporti. Bashkëpunimi midis akademive të shkencave, institucioneve arsimore (ministra, universiteti, shkollat, etj.), institucioneve kulturore e artistike e atyre sportive, gazetarëve dhe publicistëve, vizita, simpoziume, veprimtari të përbashkëta etj. (RHK)
b. Shkëmbimi i përvojës nëpërmjet shkëmbimit të grupeve të specialistëve dhe literaturës përkatëse, specializime në kuadrin e planeve kulturore, të bashkëpunimit tekniko-shkencor (15 vite).
- 5-** a. Shëndetësia – Mjedisi. Materiale mbi zbatimin e marrëveshjeve, ndihmat, bashkëpunimi, shkëmbime vizitash etj. (RHK)
b. Dokumente operative. (10 vite)
- 6-** a. Feja. Bashkëpunimi midis institucioneve fetare, shkëmbim vizitash, organizimi i aktiviteteve fetare. (RHK)
b. Dokumente operative. (10 vite)

B.IV

Gjendja e brendshme në shtete të ndryshme

- 1-** Gjendja e brendshme politike dhe ushtarake e shtetit ku është akredituar përfaqësia diplomatike e konsullore e Republikës së Shqipërisë.
 - a. - Gjendja e brendshme politike e shtetit, ndryshimet në lidhshmëri me shtetin dhe të partive; zgjedhje të reja dhe përfundimi i tyre; mbledhjet e parlamentit dhe të organeve të tjera qendrore kur trajtojnë çështje të rëndësishme; përbërjet e qeverisë; reformat shtetërore; përmbysje qeverish; gjendja në ushtri, etj. (RHK)
-Marrëdhëniet politike me shtetet e tjera ose organizma shumëpalëshe, opinione dhe qëndrime ndaj tyre, probleme të pakicave kombëtare, etj. (RHK)
- Çështje kufitare, incidente etj. midis atij vendi dhe shteteve të tjera ose organizmave shumëpalëshe. (RHK)
 - b. Partitë politike; organizatat e ndryshme; kongreset; marrëdhëniet me parti dhe organizata të vendeve të tjera. Lëvizjet e ndryshme etj. (50 vite)

- 2-** Gjendja ekonomike e vendit (50 vite)
 - a- Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik i vendit, planifikimi dhe financimi i ekonomisë, reforma ekonomike etj.
 - b-Marrëdhëniet ekonomike me vendet e tjera (tregti, kredi, ndihma, etj)

- 3-** Gjendja kulturore dhe shoqërore e vendit. (50 vite)
 - a-Zhvillimi i përgjithshëm kulturor dhe shoqëror i vendit.
 - b-Marrëdhëniet kulturore dhe shoqërore me vendet e tjera.

- 4-** Evidenca dhe informacione periodike, të përfshira në përmbledhëse, informacione dhe të dhëna të tjera që nuk përfshijnë vendin tonë, korrespondencë e thjeshtë etj. (10 vite)

B.V

Kosova dhe faktori shqiptar në rajon

1. Gjendja e brendshme në Kosovë. Zhvillimet me karakter politik, ekonomik dhe kulturor në Kosovë. Informacione dhe analiza. (RHK)
2. Deklarata, intervista, qëndrime, letra dhe telegrame të personaliteteve shtetërore shqiptare dhe atyre kosovare për qëndrimin e shtetit shqiptar ndaj Kosovës, autoriteteve të saj qeverisëse, çështjes kosovare dhe marrëdhënieve dypalëshe. (RHK)
3. Opinione, deklaratat dhe qëndrime të qeverive dhe personaliteteve të huaja, diplomatë ose jo, për Kosovën. (RHK)
4. Marrëdhëniet politike e ushtarake me Kosovën. Shkëmbime vizitash të delegacioneve shtetërore shqiptare të çdo niveli me Kosovën. Përgatitja e vizitës, tezat e bisedimeve dhe rezultatet e vizitës. Aktivitete në kuadrin e marrëdhënieve dypalëshe. (RHK)
5. a-Marrëdhënie dypalëshe ekonomike e sociale me Kosovën (RHK).
b-Oferta për bashkëpunim ekonomik e kulturor Shqipëri – Kosovë dhe faktori shqiptar në rajon (pa praktikë vazhduese) (10 vite).
6. Marrëdhënie dypalëshe kulturore e shëndetësore me Kosovën. (RHK)
7. Rënie dakort në parim për arritjen e nënshkrimit të marrëveshjeve të veçanta në fushën e bashkëpunimit politik, ekonomik dhe kulturor. (RHK)
8. Shtypi i huaj për Kosovën dhe qëndrimet ndaj saj. (RHK)
9. Faktori shqiptar në Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Luginën e Preshevës. (RHK)
10. Opinione, deklaratat dhe qëndrime të qeverive dhe personaliteteve të huaja, diplomatë ose jo, për Faktorin Shqiptar në rajon. (RHK)
11. Shtypi i huaj për Faktorin Shqiptar në rajon dhe qëndrimet ndaj tij. (RHK)

C. Organizmat ndërkombëtare.

1-Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe agjensitë e specializuara të saj.

a-Takimet dhe dokumentet përfundimtare të Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit të Sigurimit dhe organeve të tjera të OKB-së për Shqipërinë, Kosovën dhe rajonin tonë (RHK).

b-Takime të Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit të Sigurimit dhe organeve të tjera të OKB-së për probleme të tjera (20 vite).

c-Takime të agjensive, këshillave dhe organizmave të tjerë përbërës të OKB-së:

-për Shqipërinë, dhe rajonin (RHK)

-për probleme të tjera (20 vite)

d-Raportimet e shtetit shqiptar për detyrimet që rrjedhin nga Konventat e OKB-së ku ai është palë. (RHK)

e-Trajnime e bursa të dhëna nga agjensitë e OKB-së për Shqipërinë. (10 vite)

f- Ligje, vendime, udhëzime, marrëveshje, procesverbale takimesh, raporte të shtetit shqiptar që i paraqet OKB, rezoluta gjithëpërfshirëse të Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit të Sigurimit etj., Studime, evidenca statistikore etj.

2-Organizata politiko-ushtarake e Atlantikut Verior – NATO

a- Integrimi dhe Antaresimi i Shqipërisë në NATO. (RHK)

b- Marrëdhëniet Shqipërisë me strukturat e NATO-s (RHK)

d- Aktiviteti i NATO-s për Kosovën dhe rajonin tonë (RHK)

e- Aktiviteti i NATO-s për rajone e probleme të tjera - deri në vitin 2009 (20 vite)

f- Aktiviteti i NATO-s për rajone e probleme të tjera - pas viti 2009 (RHK)

g- Aktiviteti në kuadër të çështjeve të sigurisë dhe mbrojtjes kundër sulmeve kibernetike dhe desinformimit. (RHK)

3-Këshilli i Europës

a.Aktiviteti i Këshillit të Evropës (30 vite)

b.Marrëdhëniet Shqipëri – KiE (RHK)

c.Qëndrimi i KiE për Kosovën dhe rajonin (RHK).

4-Organizata për Bashkëpunimin dhe Sigurinë në Evropë - OSBE

a.Marrëdhëniet Shqipëri – OSBE (RHK)

b.Aktiviteti tjetër i OSBE-së (25 vite)

c.OSBE për Kosovën dhe rajonin (RHK)

5-Marrëdhëniet e Shqipërisë me organizatat të tjera ndërkombëtare ekonomike: FMN, Banka Botërore, Organizata Botërore e Tregtisë (OBT), Frankofonia, OKI, etj. (RHK)

Shënim : Në arkivin historiko-diplomatik në MEPJ, nuk dorëzohen nga drejtoritë përkatëse broshura apo libra të botuara nga këto organizata, aq më shumë kur këto botime nuk kanë të bëjnë fare me Shqipërinë. Ato mund t'i kalojnë Bibliotekës së MEPJ-së dhe sektorëve të saj përkatës.

C/BE

Bashkimi Evropian - BE

- 1-** Marrëdhëniet Shqipëri – BE – dhe avancimi i Shqipërisë në procesin e integritit evropian, përfshirë avancimin në negociatat e anëtarësimit. (RHK)
 - a- Teza, qëndrime, fjalime, korrespondencë me institucione të tjera. (RHK)
 - b- Informacione të përgjithshme për marrëdhëniet me institucionet e BE-së dhe politika në funksion të zgjerimit. (RHK)
 - c- Informacione të përgjithshme për zhvillimet në BE (50 vite)

- 2-** Koordinim dhe raportim për linjëzimet me politikën e jashtme, të sigurisë dhe mbrojtjes së Bashkimit Evropian, me deklaratat e Përfaqësuesit të Lartë të BE dhe me masat kufizuese të BE. (RHK)
 - a- Korrespondenca me Komitetin e Masave Shtrënguese Ndërkombëtare (RHK)

- 3-** Raportimi dhe koordinimi i punës për kapitullin 31 të legjislacionit të BE. (RHK)

- 4-** Korrespondencë për përcjelljen e informacioneve që vijnë nga Misioni pranë BE-së në Bruksel tek institucionet e linjës. (10 vite)

- 5-** Dokumente për marrëdhëniet dhe aktivitetin e Shqipërisë në nismën e Bashkimit për Mesdheun (UfM) – dosje për pjesëmarrjet e MEPJ në forumet e kësaj nisme. (RHK)

- 6-** Dokumente për marrëdhëniet, aktivitetin dhe kontributin e Shqipërisë në Procesin e Berlinit – dosje për pjesëmarrjet e MEPJ në samitet e kësaj nisme. (RHK)

- 7-** Deklarata, intervista, qëndrime, letra dhe telegrame të MEPJ për krerë dhe përfaqësues të institucioneve të BE. (RHK)

- 8-** Bashkimi Evropian, Kosova e rajoni. (RHK)



● **Organizata dhe veprimtari me karakter rajonal**

(RHK)

- 1-** Marrëdhëniet dhe aktiviteti i Shqipërisë në Paktin e Stabilitetit/RCC (Regional Cooperation Centre).
- 2-** Marrëdhëniet dhe aktiviteti i Shqipërisë në SEECP (South-Eastern Europe Cooperation Process).
- 3-** Marrëdhëniet e Shqipërisë me SECI/SELEC (South-Eastern Laë Enforcement Centre).
- 4-** Marrëdhëniet dhe aktiviteti i Shqipërisë në NEQ (Nisma e Evropës Qendrore).
- 5-** Marrëdhëniet dhe aktiviteti i Shqipërisë në BEDZ (Nisma e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi).
- 6-** Marrëdhëniet dhe aktiviteti i Shqipërisë në Nismën Adriatiko-Joniane.
- 7-** Marrëdhëniet dhe Aktiviteti i Shqipërisë në MARRI (Migration Asylum Refugees Regulation Initiative)
- 8-**Veprimtaritë rajonale me tematika të ndryshme në Ballkan/Evropa Juglindore.
- 9-**Takime tre ose katër palëshe lidhur me problematika të ndryshme për probleme dhe angazhime të përbashkëta në rajon.
- 10-**Të tjera me karakter rajonal.

D ● **Aktiviteti i Diasporës dhe shqiptarëve jashtë vendit.**

1-Diaspora dhe shqiptarët në botë.

Aktiviteti i shqiptarëve jashtë vendit sipas shteteve. (RHK)

2-Marrëdhëniet e shtetit shqiptar me Diasporën Shqiptare dhe shqiptarët jashtë vendit. Komunikimi ndërinstytucional. (RHK)

DH. • **Diplomacia e Informacionit dhe Komunikimit**

- 1.** Udhëzime, relacione, deklarata dhe informacione përmbledhëse të lëshuara nga MEPJ për informimin e publikut dhe medias (RHK).
- 2.** Informacione për median mbi veprimtarinë e titullarëve të MEPJ brenda dhe jashtë shtetit, titullarëve të përfaqësive, titullarëve të institucioneve të tjera për probleme të politikës së jashtme, intervistat e tyre në shtypin vendas dhe të huaj dhe deklaratat e tyre për shtyp.
- 3.** Informacione, analiza dhe dokumentacione që rrjedhin nga bashkëpunimi i MEPJ me organizmat ndërkombëtare që trajtojnë problemet e diplomacisë publike. (RHK)
- 4.** Informacione mbi veprimtarinë konkrete të përfaqësive tona për informimin e mediave lokale të vendeve ku janë akredituar mbi zhvillimet politike, ekonomike, sociale e kulturore të Shqipërisë dhe qëndrimin e shtetit shqiptar për probleme të caktuara kombëtare e ndërkombëtare (RHK)
- 5.** Koleksione të informacionit të përditshëm të marrë nga shtypi vendas, ai i huaj dhe interneti (3 vite – nuk dorëzohen në Arkiv).
- 6.** Programe, praktika dhe projekte të Sektorit të Teknologjisë për përmirësimin e teknologjisë në fushën e komunikimit. (RHK)
- 7.** Fotografi dhe filmime të eventeve zyrtare të organizuara nga Ministria: 1 video përmbledhëse me minutazh deri në 10 minuta dhe deri në 10 fotografi. (RHK)
- 8.** Fotografi dhe filmime të ngjarjeve historike të diplomacisë shqiptare: 1 video përmbledhëse me minutazh deri në 10 minuta dhe deri në 10 fotografi. (RHK)

E • Çështje me karakter protokollar.

1. Ceremoniali i Republikës së Shqipërisë, udhëzimet e rregullat e përgjithshme për zbatimin e tij. (RHK).
2. Ceremonialet e aktiviteteve protokollare dhe pjesëmarrja e autoriteteve në to nga përfaqësitë e të dyja palëve si pritje, dreka, masat e sigurimit të delegacioneve, darka, njoftime protokollare, etj. (10 vite).
3. Dosjet e ambasadorëve të huaj. Dokumenta lidhur me kërkesën dhe dhënien e pëlqimit (agrementit), letrat kredenciale e ato të thirrjes dhe materiale të lidhura me to. (RHK)
4. Dosjet e plota të ambasadorëve tanë gjatë kryerjes së mandatit zyrtar të detyrës së tyre jashtë vendit. (RHK)
5. Nota e dokumenta të tjera për ardhjen dhe largimin e personelit diplomatik e teknik të përfaqësive të huaja dhe paisjen e tyre me letërnjoftime e leje qarkullimi.
 - a- rregjistrat përkatës dhe libri i trupit diplomatik në Republikën e Shqipërisë. (RHK).
 - b- Nota dhe materiale të tjera me karakter teknik. (10 vite)
6. Biografi të personaliteteve të huaja jashtë Shqipërisë (5 vite)
7. Kërkesa të përfaqësive të huaja për të marrë troje për ndërtim, për godina ambasadash e banimi, kontratat e qerasë, dokumenta për çështje konkrete doganore, financiare e valutore dhe për paisje me targa automjetesh.
 - a. Kontratat për troje, godina e qera. (30 vite)
 - b. Dokumentat e tjera (10 vite)
8. Problemet e Privilegjeve dhe Imuniteteve të trupit të huaj diplomatik.
 - a. vendime, urdhëresa etj. (RHK)
 - b. korrespondencë e zakonshme (10 vite)
9. Dokumenta mbi thyerjen e rregullave të vendit nga ana e personelit të përfaqësive dhe mbi aksidentet automobilistike të tyre në vendin tonë dhe anasjelltas (20 vite).
10. Lista e protokollit tonë shtetëror, materiale protokollare për festat tona kombëtare e zyrtare dhe festime përvjetorësh historike, materiale protokollare për raste vdekjeje dhe për vizita delegacionesh e ceremoni të ngjashme shtetërore (RHK).

- 11.** Materiale për raste vdekjesh të personaliteteve udhëheqëse të Shtetit. (RHK)
- 12.** Telegramë urimi dërguar nga përfaqësitë tona për personalitetet politike shqiptare. (5 vite).
- 13.** Nota dërguar përfaqësive të huaja në Tiranë për emërimet dhe transferimet kuadrosh në Ministri (3 vite).
- 14.** Njoftime për takime të ndryshme në MEPJ të trupit diplomatik në Tiranë. (shkon tek indeksi që përfaqëson problematikën e takimit dhe merr vlerën e tij të ruajtjes)

Ë • Probleme konsullore

1. Probleme të procedurave për viza gjatë lëvizjeve.
 - a-Bisedime, rënie dakort për nënshkrimin e marrëveshjeve për heqjen e vizave diplomatike dhe të shërbimit, etj. (RHK)
 - b-Dokumenta për viza dalje e hyrje (aty ku kërkohet) për shtetasit shqiptarë që udhëtojnë për shërbim, mjekim, turizëm, riatdhesim apo nevoja personale (të ndara sipas çështjeve). (5 vite)
 - c-Praktika konsullore lidhur me marrëdhëniet e përfaqësive diplomatike të huaja në Tiranë me MEPJ për çështje vizash (5 vite)
 - ç-Dokumentat origjinale të praktikave të Drejtorisë Konsullore për kërkesat që vijnë nga përfaqësitë tona jashtë për viza të shtetasve të huaj që udhëtojnë për në Shqipëri (15 vite).

2. Marrëdhëniet e përfaqësive të huaja në Tiranë me MEPJ për çështje të zakonshme konsullore. (10 vite)

3. Regjistra për lëshim pasaportash dhe vizash:
 - a- Diplomatiqe e shërbimi (RHK)
 - b- Të zakonshme (50 vite)

4. Mbrojtja dhe asistenca konsullore ndaj shtetasve shqiptarë (15 vite)
 - a) Regjistrat (RHK)

5. Çështjet për fitimin, rifitimin dhe lenie shtetësisë shqiptarë (15 vite)
 - a) Regjistrat (RHK)

6. Paisja me dokumente (pasaporte, ID, leje kalimi, leje transporti trupi (10 vite)
 - a) Regjistrat (RHK)

7. Aktet e gjendjes civile
 - a) Regjistrat (RHK)
 - 1-Akt Lindje (25 vite)
 - 2-Akt Martese (25 vite)
 - 3-Akt Vdekje (25 vite)
 - 4-Regjistrim fëmije (10 vite)
 - 5-Regjistrim Martese (10 vite)
 - 6-Regjistrim Vdekje (10 vite)
 - 7-Lidhje Martese me shqiptar (35 vite)
 - 8-Lidhje Martese me të huaj (35 vite)
 - 9-Çertifikatë Lindje-Përfaqësitë që e lëshojnë (5 vite)
 - 10-Çertifikatë Martese-Përfaqësitë që e lëshojnë (5 vite)
 - 11-Çertifikatë Vdekje -Përfaqësitë që e lëshojnë (5 vite)
 - 12-Çertifikatë Familjare-Përfaqësitë që e lëshojnë (5 vite)

13-Leje Martese (Nulla Osta Matrimonio)-Përfaqësitë në Itali (20 vite)

8. Aktet noteriale

a) Regjistrat (RHK)

1- Prokure e Posaçme(25 vite)

2- Deklaratë noteriale(25 vite)

3-Ekstrakt dokumenti (Dublikatë) (10 vite)

4-Autentifikim nënshkrimi (10 vite)

5-Procesverbal (10 vite)

6-Njehsimin e kopjes me origjinalin (10 vite)

9. Vertetime te ndryshme (15 vite)

a) Regjistrat (RHK)

10. Përkthimet (5 vite)

a) Regjistrat (RHK)

11. Legalizimet (15 vite)

a) Regjistrat (RHK)

12. Biresimet (50 vite)

13.Vendime, urdhëra, etj. që lidhen me:

a-dhënien e pasaportave diplomatike e të shërbimit dhe zgjatjen e afatit të tyre. (RHK).

b-dhënien e pasaportave të zakonshme për shtetasit shqiptar (10 vite)

14. Dokumenta konsullore për çështje pasurish e pensionesh. (RHK)

15. Dokumenta lidhur me të humburit, të dënuarit, të plagosurit ose të vraret, etj. (25 vite).

a- Shqiptar, b-të huaj

16. Udhëzime, raporte dhe informacione konsullore:

a- ato me karakter përmbledhës e orientues (RHK)

b- ato të përfaqësive tona dhe ato me të dhëna të zakonshme takimesh, etj. (10 vite).

17.Dokumenta lidhur me lejen dhe qarkullimin e mjeteve të çdo lloji të transportit dhe aksidentet e tyre si edhe njoftimet karantinore. (5 vite)

18.Dokumenta e praktika lidhur me emërimin e konsujve të nderit. (RHK).

19.Praktika e emërimit të Konsujve të huaj të Përgjithshëm në Shqipëri (RHK)

F ● **Praktikat për nënshkrimin dhe ratifikimin e traktateve e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe dhe problemet e tjera juridike të lidhura me to. Çështje të së drejtës së detit.**

- 1-** Praktika të marrëveshjeve dypalëshe dhe instrumentave të tyre të miratimit dhe ratifikimit (projekt ose akt zyrtar i miratuar). (RHK)
- 2-** Praktika të marrëveshjeve shumëpalëshe dhe instrumentat e tyre të miratimit dhe ratifikimit (projekt ose akt zyrtar i miratuar). (RHK)
- 3-** Plotfuqi, kredenciale. (RHK)
- 4-** Lista të marrëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe të nënshkruara nga shteti shqiptar që vijnë në MPJ nga institucionet e tjera qendrore. (RHK)
- 5-** Gjykatat ndërkombëtare dhe probleme të së drejtës ndërkombëtare (RHK)
- 6-** Analiza për probleme të ndryshme të së drejtës ndërkombëtare (RHK)
- 7-** Aktiviteti mbi praktikat për nënshkrimin dhe ratifikimin e traktateve e marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe dhe problemet e tjera juridike të lidhura me to, si dhe mbi çështjen e të drejtës së detit. (RHK)
a-Probleme rutinë (10 vite)
- 8-** Vendime të Këshillit të Ministrave dhe praktika e tyre juridike për probleme të ndryshme të politikës së jashtme. (RHK)
- 9-** Vendime të Këshilli të Ministrave me objekt jashtë fushës së politikës së jashtme dhe marrëdhënieve ndërshtetërore dhe mendimet e dhëna nga strukturat e MPEJ –së gjatë procesit të miratimit të tyre (10 vite).

H • **Administrimi dhe përpunimi i dokumentacionit diplomatik, deklasifikimi dhe shfrytëzimi i pasurisë arkivore. Biblioteka e MEPJ-së.**

1. Regjistrat e protokollimit të dokumentacionit që hyn e që del në MEPJ, katalogët e dokumentacionit arkivor, skedari, skemat e klasifikimit apo udhëzime për përpunimin e dokumentacionit arkivor. (RHK)

2. Bashkëpunimi me arkivat homologe jashtë vendit. Praktikrat për arritjen e marrëveshjeve të bashkëpunimit dypalësh në këtë fushë. Pjesëmarrja në aktivitete ndërkombëtare dhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta. (RHK)

3. Udhëzime, praktika pune për trajtimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” në MEPJ e përfaqësi (RHK)

4. Bibliografite e dokumenteve të deklasifikuara ose jo. (RHK)

5. Praktika e punës e Komisioneve:

a- Komisioni i Deklasifikimit dhe Vendimet e tij. (RHK)

b- Veprimtaria e komisioneve të ekspertizës, pëcaktimi i vlerës së ruajtjes, asgjësimi i dokumenteve në Ministri dhe përfaqësi, procesverbalet përkatëse. (RHK)

6. Praktikrat e organizimit të ekspozitave dokumentare për tema të caktuara të politikës së jashtme (RHK)

7. Pasurimi i arkivit të MPJ-së me dokumentacion:

a. Dorëzimi i dokumentacionit nga Arkivi në veprim i MEPJ dhe institucionet e varësisë në Arkivin Historik (RHK)

b. Praktika deri në tërheqjen e dokumentacionit arkivor nga burime jashtë MEPJ. (RHK)

c. Dokumentacioni i marrjes në dorëzim të dokumentacionit arkivor të tërhequr. (RHK)

8. Shfrytëzimi i dokumentave arkivore dhe rregullat përkatëse.

a. Regjistrat e evidentimit të shfrytëzuesve të dokumentacionit arkivor dhe të llojit të materialit që kanë shfrytëzuar, rregullat e shfrytëzimit së bashku me dosjet e miratuara të shfrytëzuesve (RHK)

b. Praktikrat e pamiratuara për dhënie për shfrytëzim të dokumentacionit (5 vite)

c. Praktikrat e komunikimit me institucionet e tjera shtetërore për problemet arkivore (10 vite)

d. Praktikrat e komunikimit me publikun (10 vite)

e. Korrespondenca me njësitë strukturore dhe të varësisë në lidhje me punën me dokumentet dhe sigurinë e informacionit. (10 vite)

- 9.** Praktikrat për realizimin e botimeve të dokumenteve arkivore (50 vite)
- 10.** Studime e botime të dokumentave arkivore. (RHK)
- 11.** Dosjet e praktikës së hulumtimit arkivor të shfrytëzuesve jashtë shërbimit të jashtëm. (10 vite)
- 12.** Korrespondenca me përfaqësitë.
- kujtesa, konsultime, sqarime (5 vite)
-tërheqje vëmendjeje për punën me dokumentacionin, dërgim materialesh udhëzuese (10 vite)
- 13.** Probleme të Arkivit Historik e Diplomatik për bazë materiale, për probleme teknike të mirëmbajtjes së fondeve arkivore (10 vite)
- 14.** Problemet e laboratorit të mikrofilmimit, restaurimit, dublimit (20 vite)
- 15.** Kontrollat për mënyrën e administrimit të dokumentacionit në Drejtorinë e MEPJ dhe në institucionet e varësisë, praktika e realizimit të tyre, procesverbalet përkatëse, aktet e kontrollit, informacionet përmbledhëse (RHK)
- 16.** Probleme të Sekretarisë Qëndrore (10 vite)
- 17.** Biblioteka dhe problemet e saj :
a. Inventarët, skedarët (RHK)
b. Fletët e regjistrimit të lexuesve, praktikrat e blerjeve të titujve të rinj (10 vite)
b. Problemet teknike (5 vite)
- 18-** Lista konkrete (tip) e afatit të ruajtjes së dokumenteve. (RHK)
- 19-** Pasqyra emërtuese e çeljes së dosjeve në MEPJ dhe në institucionet e varësisë. (RHK)
- 20-** Inventari i dosjeve të arkivuara në arkivin në veprim. (RHK)
- 21-** Regjistrat e korrespondencës, Librat e dorëzimeve. (RHK)

I ● Probleme të menaxhimit të burimeve njerëzore

- 1.**Organikat e Ministrisë dhe të përfaqësive dhe praktikat e miratimit të tyre. (RHK)
- 2.**Emërime, transferime, ngritje në detyrë, lirim nga detyra, largime, ndryshim niveli page për punonjësit në MEPJ. (RHK)
- 3.**Dosja e personelit të përfaqësive diplomatike e konsullore ku pasqyrohen të gjitha lëvizjet e personelit, ndryshimet e pozicionit dhe pagës, dhe ndodhet në Arkivin e përfaqësisë. (RHK).
- 4.**Praktikat teknike të hapjes dhe të mbylljes së përfaqësive diplomatike dhe konsullore. (RHK)
- 5.** Gjyqet e MEPJ-së me personelin e larguar nga MEPJ (20 vite).
- 6.** Praktika e dërgimit me shërbim shtetëror jashtë apo brenda vendit të grupeve apo individëve punonjës në strukturat e shërbimit të jashtëm shqiptar. (10 vite)
- 7.** Rregjistrat me të dhënat e punonjësve të MEPJ-së. (RHK)
- 8.**Praktika të kualifikimit dhe trajnimit të personelit, kurset periodike. (10 vite)
- 9.**Informacione përmblledhëse, relacione vjetore për problemet e personelit në MPJ e përfaqësi (RHK)
- 10.**Problemet që lidhen me standartet e shërbimit civil në MPJ (20 vite).
- 11.**Problemet që lidhen me standartet e shërbimit të jashtëm në MEPJ. (50 vite).
- 12.**Dokumentacioni i punës së Komisionit të Gradave.
 - a- Procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit të Gradave. (RHK)
 - b- Materialet e punës për një takim të Komisionit të Gradave. (5 vite)
- 13.**Evidenca operative dhe periodike, korrespondencë për probleme të zakonshme, kërkesa e ankesa. (10 vite)
- 14.**Dokumenta lidhur me personelin vendas që punësohet në përfaqësitë tona jashtë shtetit (30 vite pas largimit).

15.Planet vjetore ose me afat më të gjatë për strehimin, lejet e zakonshme dhe informacionet periodike për këto probleme. Kurimin e personelit, të fëmijëve dhe të afërmeve të tyre jashtë. Sistemimi në shkolla i fëmijëve të personelit të përfaqësive tona jashtë. (10 vite)

16.Dosjet e personelit të MPJ dhe përfaqësive (120 vite pas lindjes).

17. Dosjet personale të Ambasadorëve dhe të Konsujve të Përgjithshëm (RHK).

18- Vendime, udhëzime, regjistra, tërësia e dokumentacionit teknik të objekteve etj. për objektet në përgjegjësi administrimi të institucionit. (RHK)

19- Evidenca dhe informacione periodike, të përfshira në përmbledhëse, korrespondencë e thjeshtë etj. (10 vite).

J ● **Çështje financiare dhe administrative**

- 1.** Planet me karakter administrativ, ekonomik dhe financiar me afat vjetor ose më të gjatë për Ministrinë dhe për përfaqësitë. (RHK)
- 2.** Buxheti vjetor, bilancet përmbledhëse vjetore, pasqyrat vjetore të llogarive të përfaqësive. Transferim fonde, dërgesa (RHK).
- 3.** Tabela dhe udhëzime për alokacione dhe dieta. Kursi i këmbimit (RHK)
Vendimet e Këshillit të Ministrave për financat në MEPJ (RHK)
- 4.** Pagat, alokacionet, shpërblimet e kuadrove dhe familjeve të tyre
 - a. Borderotë kur mungon Libri i Pagave (RHK)
 - b. Libri i Pagave (RHK)
 - c. Borderotë kur ekziston Libri i Pagave (10 vite)
 - d. Dokumentet për shpërblimin e familjeve (10 vite)
- 5.** Dokumentat mbi pullat e taksat konsullore e gjendjen e tyre (10 vite)
- 6.** Aktet e kontrollit ekonomik e financiar dhe raportet përkatëse :
 - a. Raportet përmbledhëse ose që janë dërguar për gjykim (50 vite)
 - b. Ato të zakonshme (10 vite)
- 7.** Regjistrat kontabël dhe evidencat mbështetëse ruhen për 10 vite rresht pas mbylljes së vitit ushtrimor kontabël, të cilit i përkasin, përveç atyre që, me ligj ose me akt tjetër nënligjor, përcaktohet një afat më i gjatë ruajtjeje. I njëjti afat zbatohet edhe për dokumentet informatike (bartësit) dhe printimet e tyre.
- 8.** Dokumentet justifikues të shpenzimeve për automjetet në MEPJ e përfaqësi. (10 vite)
- 9.** Korrespondenca e zakonshme me karakter administrativ, ekonomik dhe financiar me përfaqësitë tona jashtë dhe me institucione e tjera. (10 vite)
- 10.** Praktikat e tenderave që zhvillohen në MEPJ dhe përfaqësi për blerje mallrash e shërbimesh. (20 vite).
- 11.** Kontratat e qerasë të godinave të përfaqësive tona jashtë shtetit dhe të banesave të personelit, gjendja e godinave dhe e paisjeve, planimetritë e tyre etj. Probleme të godinës së ministrisë. (30 vite)
- 12.** Kontratat për sigurimin shëndetësor të trupit diplomatik e konsullor që shërben jashtë vendit. (10 vite)

- 13.** Gjyqe për probleme të ndryshme të MPJ-së me institucionet e tjera në vend. (20 vite)
- 14.** Aktet e auditimit të brendshëm, sipas llojeve të auditimeve, dhe raportet përkatëse:
- a. Raportet përfundimtare të auditimeve së bashku me anekset bashkëlidhur. (RHK)
 - b. Dokumentacioni i cili është pjesë e dosjes së auditimit (10 vite).